



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 4, datë 15/02/2021

MBI

**“DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE  
ME KOHË TË PLOTË BACHELOR DHE RREGULLOREN E CIKLIT TË DYTË TË  
STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË MASTER  
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve nisur nga kërkesa e Fakultetit të Muzikës “Mbi disa ndryshime lidhur me mbrojtjen e Diplomës në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master” si dhe në zbatim të nenit 38, të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” pasi shqyrtoi propozimin e ardhur nga Fakulteti i Muzikës të protokolluar me Nr. 237 Prot, datë 15.09.2020 të FM dhe me Nr. 820, Prot., datë 16.09.2020 të UART, pas diskutimeve dhe me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në rregulloret e studimeve të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master si më poshtë:
  - i. Në rregulloren e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor Neni 34, pika 3 e tij shfuqizohet.
  - ii. Në rregulloren e ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master Neni 33, pika 3 e tij shfuqizohet.
2. Studenti gëzon të drejtën e dhënies së provimit të diplomës brenda afateve të përcaktuara në Nenin 90, pika 1 e tij, e Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca si dhe tu dërgohet për zbatim Fakulteteve në UART.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Dea SHUBLEKA (Studente FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)